REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 901/20
Datë/Datum. 09.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *Korporates Energjetike te Kosoves, nr. i prokurimit: KEK 20 4730 121*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK0 20 284 121 (i brendshem)**

Sa i përket tenderit për Furnizim me elemente lidhese per rule

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Univers – M shpk
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Eqrem Qabej, pn
(Adresa)
Milloveshe, Obiliq *15050*
(Vendi) *(Kodi postar)*
044 276 071
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Zt. Tefik Hargaja, Drejtor i Kompanise
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Univers.m.pr@gmail.com
(Adresa elektronike)

21 tetor 2020
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

parashihen te furnizohen mbeshteten 'eksluzivisht' ne vizatime teknike.

Eshte me rendesi te njoftojme OSHP-ne se ne fazen e procesit te prokurimit nuk ka pasur asnje Kerkese per Sqarime te Dosjes se Tenderit per 'parametrat' e specifikacioneve teknike te detyrueshme dhe ne vizatime teknike nga asnje konkurrues dhe produktet e tyre duke treguar qe si vizatimet teknike dhe parametrat e specifikacioneve teknike te detyrueshme kane lejuar prodhimin e produkteve te parapara per furnizim me elemente lidhese per rule dhe nuk do te kishte asnje pengese gjegjesisht nuk do te paraqiste asnje problem ne implementim te kontrates publike.

Autoriteti Kontraktues, nuk ka publikuar dhe derguar as Letrat per Tenderuesit e Eliminuar dhe nuk ka publikuar Njoftimin per Anulimin e Tenderit duke shkelur nenin 42 te Ligjit te Prokurimit Publik te Kosoves.

Me daten 15 tetor 2020, Autoriteti Kontraktues, refuzon Kerkesen per Rishqyrtim dhe pergjigjet duke mos ofruar argumente ligjore ne argumentet ligjore te Kompanise 'Univers – M' shpk ne menyre konkrete dhe ligjore por mbeshtet ne vleresimet e anetareve te komisionit per vleresimin e ofertave qe kane rekomanduar anulimin e tenderit.

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Kompania 'Univers – M' sh.p.k, pas analizimit dhe studimit te dokumenteve relevante te Autoritetit Kontraktues dhe pas Vendimit te saj kunder Kerkeses per Ri-shqyrtim ne proceduren e prokurimit per: *Furnizim me elemente lidhese per rule,* konsideron se Autoriteti Kontraktues, ka bere shkelje te dispozitave ligjore te Ligjit te Prokurimit Publik te Kosoves.

Dispozitat e shkelura nga ***Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosoves,*** jane mese vijon:

- *Eshte shkelur neni 59.2 dhe neni 59.4, i Ligjit te Prokurimit Publik*
- *Eshte shkelur neni 28, i Ligjit te Prokurimit Publik*
- *Eshte shkelur neni 2.1 dhe 3.1 i Dosjes se Tenderit*
- *Eshte shkelur neni 72, i Ligjit te Prokurimit Publik*
- *Eshte shkelur neni 42, i Ligjit te Prokurimit Publik*
- *Eshte shkelur neni 1, 6, dhe 7, i Ligjit te Prokurimit Publik*

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. **Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kompania 'Univers – M' sh.pk, pas analizimit te teresishem te dokumenteve relevante te Tenderit per: *Furnizim me elemente lidhese per rule* konstaton dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosoves, ka bere shkelje ligjore ne mos vleresimin e drejte, real dhe objektiv te Ofertes sone qe eshte Oferte performuese dhe ne pajtim me kerkesat, kushtet dhe kriteret e percaktuara ne Dosje te Tenderit.

Pikat e Ankeses per shkeljet e pretenduara te Autoritetit Kontraktues *jane te prezentuara si me vijon*:

1. Autoriteti Kontraktues, me daten 08 / 10 / 2020, nepermjet portalit E-prokurimi te KRPP-se, publikon Njoftimin mbi Vendimin per Anulim te Kontrates per prokurimin: *Furnizim me elemente lidhese per rule* por pa publikuar Njoftimin per Anulim dhe as dergimin e Letres per Tenderuesin e Eliminuar.

2. Kompania 'Univers – M' sh.p.k pas publikimit te Njoftimit mbi Vendim per Anulim te Kontrates, me daten 12 / 10 / 2020, ka pergaditur dhe dorezuar Kerkesen per Ri-shqyrtim ne Autoritetin Kontraktues.

   Ne Kerkesen per Ri-shqyrtim kemi listuar argumente te mjaftueshme ligjore qe Oferta jone eshte ne pajtim me kerkesat, kushtet dhe kerkesat e Autoritetit Kontraktues.

   Gjitheashtu, ne Kerkesen per Rishqyrtim, kemi potencuar se ne Vendimin per anulim te kontrates publike jane cekur vetem 'arsyetime te pergjithshme' per anulim te tenderit duke mos ofruar arsyetime specifike teknike, ligjore dhe profesionale per mos-perputhje te parametrave te specifikacioneve teknike te detyrueshme me vizatimet teknike.

3. Autoriteti Kontraktues, me daten 15 / 10 / 2020, ka dorezuar Vendimin per Refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim, si dhe Kopjen e Raportit te Vleresimit te Ofertave.

   Ne Vendimin per Refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues, jep arsyetime te pabazuara dhe te pa-faktuara qe sipas mendimit te Kompanise sone, i mohohet e drejta e fitimit te kontrates publike ne menyre te rregullte pasi qe kemi ofruar tenderin e pergjegjshem me emim me te ulte;

4. Ne nderlidhshmeri, me piken 3, te kesaj Ankese, Kompania 'Univers – M' kundershton arsyetimet e ofruara te Autoritetit Kontraktues ne Vendimin e saj per refuzim te Kerkeses per Rishqyrtim, te dates 15 / 10 / 2020, ngase te dhenat e parametrave te specifikimeve teknike te detyrueshme te pershkruara ne Aneks 1 te dosjes se tenderit me te dhenat ne vizatimet teknike nuk jane me gabime teknike dhe permbajtesore (*diskrepance te madhe teknike, mekanike dhe teknologjike*) sa duhet te anulohet tenderi ngase Produkti i ofruar nga 'Univers – M' shpk por edhe nga konkurruesit e tjere qe kane ofertuar do te kishte perputhshmeri dhe do ruante plotesisht aspektin funksional dhe performues, ashtu sic kerkohet qe produktet te jene funksionale dhe performuese sipas nenit 28 (*specifikacionet teknike*) te Ligjit te Prokurimit Publik te Kosoves.

   Ne kete drejtim, Autoriteti Kontraktues, sic e kemi theksuar edhe ne Kerkesen per Rishqyrtim, ka pasur per obligim ligjor qe sipas nenit 59.2 dhe nenit 72 te Ligjit te Prokurimit Publik te kerkoje sqarime mbi oferten tone per produktet e ofruara per elementet lidhese per rule dhe ne baze te krahasimit teknik dhe profesional me parametrat e specifikacioneve teknike te detyrueshme te Aneks 1 te dosjes e tenderit dhe vizatimeve teknike te merrte vendim ligjor qe Produkti i ofruar nga Kompania 'Univers – M' shpk eshte substancialisht dhe plotesisht funksional per perdorim ne baze te specifikacioneve teknike qe nje produkt duhet te jete funksional, ashtu sic eshte pershkruar qarte edhe ne permbatjen e nenit 28 te Ligjit te Prokurimit Publik te Kosoves;

5. Ne nderlidhshmeri, me piken 3 dhe 4, te kesaj Ankese, Kompania 'Univers – M' shpk, ripotencon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 3.1 te dosjes se tenderit ku ne menyre

ligjore dhe specifike ceket se nje Tender konsiderohet i pergjegjeshem kur ai tender eshte plotesisht ne pajtim me vizatimet teknike dhe specifikacionet teknike dhe aspektet tjera teknike, ligjore dhe financiare.

Prandaj, nuk eshte i vertete konstatimi i Autoritetit Kontraktues, i cekur ne Vendimin per Refuzim te Kerkeses per Rishqyrtim qe do te paraqiste 'dualizem' ne vendim marrje se a duhet te respektohen vizatimet teknike ose specifikacionet teknike ngase neni 3.1 dhe pikes 2.1, Aneks 1 i Dosjes se Tenderit cek shprehimisht qe, citat: ..... **Specifikimi Teknik per pjeset e kerkuara jane te cekura ne te dhenat teknike te Elementeve lidhese te ruleve dhe keto te dhena jane ne VIZATIME dhe pjese perberese e Dosjes se Tenderit jane edhe VIZATIMET TEKNIKE te bashkengjitura.**

Si rezultat i saj, edhe njehere ri-potencojme se Oferta e Kompanise 'Univers – M' shpk eshte e pergjegjeshme, performuese dhe produktet e ofruara me Oferte jane plotesisht funksionale, ashtu sic kerkohet me nenin 28 te Ligjit te Prokurimit Publik dhe nuk do te paraqiste asnje problem gjate implementimit te kontrates publike.

Duke u nisur nga kjo, ashtu sic kemi potencuar edhe ne Kerkesen per Rishqyrtim, ndonje gabim eventual teknik i vogel ndermjet te dhenave te pershkruara ne te gjitha parametrat e specifikacioneve teknike te detyrueshme ne Aneks 1 dhe ne vizatime teknike nuk jane me 'diskrepance' te madhe dhe qe nuk rezultojne ne mos furnizim te produktit cilesor dhe qe nuk kane 'asnje ndikim' ne Vizatime Teknike ne baze te se ciles edhe eshte pergaditur Oferta atehere ka qene shkelje ligjore vendimi i KEK per anulim te tenderit ngase Oferta jone eshte oferte e pergjegjeshme sipas nenit 59.4 te LPP-se edhe nese ne specifikacion teknik mund te gjenden gabimet e vogla teknike qe nuk jane permbajtesore dhe qe nuk kane asnje ndikim sepse Oferta per produktet e kerkuara nga KEK eshte e bazuar ne vizatime teknike qe ne mase permbajtesore ka qene ne rregulle.

6. Ne nderlidhshmeri, me piken 3, 4 dhe 5, te kesaj Ankese, Kompania 'Univers – M' shpk, **do te bashkengjes ne word dokument Kundershtimet tona si Prove** me ane te se ciles argumentojme ne aspektin teknik dhe profesional me ilustrim/shembull konkret qe arsyetimet e ofruara ne Vendimin per Refuzim te Kerkeses per Rishqyrtim, Anulim te Kontrates Publike dhe ne Raportin e Vleresimit te Ofertave ne ceshtjet ku flitet per mos perputhje ndermjet te dhenave ne specifikacionin teknik te Aneks 1 te dosjes se tenderit dhe vizatimeve teknike **jane vleresime te gabuara profesionale dhe gabim ligjor i Korporates Energjetike te Kosoves.**

   Me kundershtimin tone si pale ankuese japim sqarime konkrete teknike per te bindur Ekspertin Teknik dhe Anetaret e Panelit Shqyrtues te OSHP-se qe gabimet e vogla teknike dhe mos perputhjet eventuale nuk kane pasur asnje ndikim total dhe permbajtesor ne Vizatimet Teknike dhe **qe produktet e ofruara sipas Vizatimit Teknik, ashtu sic ka qene e parapare me piken 2.1 te Aneks 1 te specifikacioneve teknike te detyrueshme dhe neneve 3.1 dhe 3.2 te dosjes se tenderit jane produktet plotesisht funksionale dhe performuese, ashtu sic kerkohet me nenin 28 te Dosjes se Tenderit dhe nuk do te kishte asnje problem ne implementim te kontrates publike.**

   Duke refuzuar Oferten e Kompanise 'Univers – M' shpk, Korporata Energjetike e Kosoves, ka shkelur piken 2.1 te Aneks 1, dhe neneve 3.1 te dosjes se tenderit ne te cilet thirret KEK por edhe ne nenin 28, 59.2, 59.4 dhe nenin 72 te Ligjit te Prokurimit Publik te Kosoves (**PROVE: Kundershtimi teknik si Prove ndaj arsyetimeve te pabazuara te KEK**).

   Autoriteti Kontraktues, ka shkelur edhe nenin 1, 2, 6 dhe 7 te Ligjit te Prokurimit Publik te Kosoves ngase po diskriminohet rende Kompania 'Univers – M' shpk ne mos nenshkrimin e kontrates publike qe ka ofruar emimin me te ulte dhe oferte te pergjegjeshme.

7. Kompania 'Univers – M' shpk **garanton per cilesine e produktit qe ri-konfirmon qe produkti i ofruar ne Oferten tone eshte ne pajtim te plote me Vizatimet Teknike sipas pikes 2.1, Aneks 1, te specifkacioneve teknike te detyueshme te dosjes se tenderit (pjese e specifikacionit teknik** te detyrueshem) dhe **nuk ka asnje ndikim ne performancen dhe funksionalitetin e produktit te kerkuar nga Korporata Energjetike e Kosoves** ngase Oferta **jone ne teresi i pergjigjet Vizatimeve Teknike** dhe vete Parametrave – dimensioneve te dhena ne Vizatime Teknike; dhe

8. Autoriteti Kontraktues, pas deponimit te kerkeses per qasje publike, ka ofruar qasje publike duke marre kopjen e Raportit te Vleresimit te Ofertave.

Ne raportin e vleresimit te ofertave ceken te njejtat arsyetimet specifike teknike te mos perputhjeve sikurse ne Vendimin per Refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim por qe per arsye te panjohura dhe jo ligjore duke shkelur nenin 42 nuk ben publikimin e Njoftimit per Anulim te Kontrates Publike duke shfrytezuar Formen e KRPP-se per anulim te kontrates nuk e ka publikuar ne portalin e E-Prokurimi dhe arsyetimi i ofruar per kete ceshtje ne Vendimin e dates 15 / 10 / 2020 eshte jo ligjor.

Sic kemi theksuar ne Kerkesen per Rishqyrtim, KEK, ka perdorur formen jo ligjore te Njoftimit per Vendim mbi Anulim te Kontrates Publike ngase jane mbeshtetur ne nenin 43.7 te Udhezuesit Operativ qe aktualisht nuk eshte ne fuqi.

Shenim per argumentet ligjore te potencuara ne Ankese dhe faktet e bashkengjitura:

Ne pajtim me Rregulloren per Trajtimin e Ankesave dhe sic parashihet edhe me nenin 108 / A te Ligjit te Prokurimit Publik pretendimet ankimore jane te njejta ku si parashtrues i Ankeses kemi ofruar arsyetimet tona ligjore dhe mos pajtimet ne arsyetimet e ofruara ne Vendimin per Refuzim te Kerkeses per Risqyrtim kundrejt argumenteve ligjore te potencuara ne Kerkesen per Rishqyrtim.

Ne parashtrim te Ankeses ne OSHP bejme edhe deponimin e provave relevante materiale me numer rendor per te i ofruar argumente te mjaftueshme ligjore si eksperteve por edhe anetareve te panelit shqyrtues te OSHP-se per te konstatuar drejte dhe ligjshem gjendjen faktike per lenden e kontestuar.

Perfaqesuesit e Kompanise si parashtrues te Ankeses ne OSHP jane ne dispozicion qe sipas Rregullores se Punes se OSHP-se por edhe ne baze te nenit 108 / A te Ligjit te Prokurimit Publik te ofroje sqarime lidhur me permbajten e argumenteve tona dhe provave te potencuara ne Ankese para Ekspertit dhe Panelit Shqyrtues poqese kerkohen sqarime lidhur me permbatjen e Ankeses.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kompania 'Univers – M' sh.p.k, me plotesimin e te gjitha kerkesave/kushteve te tenderit ka interes te caktuar materialo-juridik ne parashtrimin e Ankeses dhe ka qene Ofertuesi potencial per fitimin e kontrates publike ngase ka plotesuar te gjitha kerkesat dhe kriteret e Autoritetit Kontraktues, si dhe ka ofertuar me cmimin me te lire dhe ka pasur oferte te pergjegjeshme.

Prandaj, mos fitimi i nje kontrate publike ne menyre te rregullte ndikon ne shpenzime ligjore, humbje te fitimit real nga mos realizimi i projektit, si dhe reputacioni i Kompanise sone ne tregun e Kosoves.

PROPOZIM

Duke u nisur nga prezentimi i argumenteve ligjore me arsyetim ligjor ne Ankese, Kompania 'Univers – M' shpk kerkon nga Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues te Prokurimit te beje shoshitjen e fakteve ne menyre ligjore duke marre **Vendim per te kthyer lenden e kontestuar ne RI-VLERESIM te OFERTAVE,** ne menyre qe Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosoves, te beje vleresim te serishem te ofertave dhe te shpall fitues Kompanine 'Univers – M' shpk qe ka plotesuar te gjitha kushtet, kerkesat dhe kriteret e Autoritetit Kontraktues te potencuara ne Dosje te Tenderit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.